**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
**KOMUNA E GJAKOVËS**
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.05.20

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 08.05.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **FONDERIA E & E " SH.P.K.**,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe vendosja e kapakëve t pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, ulëseve për parqe dhe kontejnerëve", Nr. i prokurimit- 632-23-2711-1-2 1, Nr. i brendshëm-632-23-035 -121**, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **FONDERIA E & E " SH.P.K** e **dt.08.05.2023,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, uleseve për parqe dhe kontejnerëve", Nr. i prokurimit- 632-23-2711-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-035 -121**, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, **i publikuar me datë: 24.04.2023;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

**A r s y e t i m**

Me dt.08.05.2023, Operatori Ekonomik " **FONDERIA E & E " SH.P.K,** ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: **"Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, uleseve për parqe dhe kontejnerëve", Nr. i prokurimit- 632-23-2711-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-035 -121.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë, lidhur me marrëveshjet për makineritë e huazuara është i pa bazuar, sepse OE " Bereqeti –Ing", i prezantuar marrëveshjet dhe listat e makinerive te huazuara me OE "Genti" dhe OE "CO-ING"

# Marreveshje

AK: KOMUNA E
GJAKOVËS

Per projektin: Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, ulëseve për parqe dhe kontenjerëve

Nr i prokurimit 632-23-2711-1-2-1

Ne baze te marreveshjes se arritur ne mes te "BEREQETI — ING me nr te biznesit 81 0845638 nga Malisheva e perfaqesuar nga Arben Mazreku dhe Ndermarrjes NNT GENTI me nr. Te biznesit 810784878 me seli ne Podujevë e pe#aqesuar nga Hajzer Hajdari,eshte vendosur qe per realizimin e projektit te perdoren mjetet sipas dokumentacionit te cilen do ja bashkangjesim kesaj marreveshje

Mjetet e punes do te punojne sipas dinamikes dhe kerkeses se realizimit te projektit ne fjale.

Marrëveshja eshte e vlefshme per periudhen e realizimit te projektit ,gjegjesisht sipas planit dinamik.

Podujevë me :17.04.2023

"BEREQETI — ING

Arben Mazreku

Kompani Projektuese Ndertimore Ndihmuese BEREQETI-ING sh.p.k.

NNT GENTI

Hajzer Hajdari

N.N.T. GENTI PODUJEVË

| Vlen deri: Важи до: Valid to: 23.09.2021 Vula: Печат: Stamp: Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: | Vlen deri: Важи до: Valid to: 08.12.2022 Vula: Печат: Stamp: Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: |
|---|---|
| Vlen deri: Важи до: Valid to: Vula: Печат: Stamp: 16.12.2023 Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: | Vlen deri: Важи до: Valid to: Vula: Печат: Stamp: Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: |
| Vlen deri: Важи до: Valid to: Vula: Печат: Stamp: Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: | Vlen deri: Важи до: Valid to: Vula: Печат: Stamp: Nënshkrimi i personit zyrtarë: Потпис службеног лица: Official signature: |

CRA/УРВ/VRC 1541384

CRA/УРВ/VRC 1541384

REPUBLIKA E KOSC
РЕПУБЛИКА КОСС
REPUBLIC OF KOS

RKS

CERTIFIKATA E REGJIfi
AUTOMJETIT
УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИ
VEHICLE REGISTRA
CERTIFICATE

01-254-C

CRA/УРВ/VRC 15

A Numri i regjistrimit;

211 CDI

P Motorri; Motor; Engine;

Date of registration;

Të dhënat personale;
Лични подаци;
Personal data:



Viti i prodhimit; Година производње; Year of production;

Капацитет места за седење; Seating capacity 7

P3 Lloji i karburantit ose burimi i energjisë; Врста горива или напајање; Type of fuel or power source; Dizel - EURO 4

R Ngjyra e automjetit; Боја возила; Color of the vehicle; 2 - E PORTOKALLTË

S.2

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C.2.3 Adresa; | | | D3 | Përshkrimet komerciale; Комерцијални описи; | | | |
| | I | Data e regjistrimit; Датум регистрације 23.09.2020 | E | Numri identifikues i automjetit; Идентификациони број возила; Vehicle identification number WDB9026221R811563 | | P1 | Kapaciteti (në cm3); Запремина (у цм3); Capacity (in cm3); |
| D Automjeti; | C | | S | 2006 | | P2 | Fuqia maksimale neto (në kW); Максимална нето снага (у кВ); Maximum net power (in kW); |
| D.1 Prodhuesi; Произвођач; Make: | ç | Pronari i mjetit, Власник возила; Omcfofio ebicle Pesha e automjetit; Маса возила; Mass of the | S | Kapaciteiji uleseve; | | | |
| D.2 Tipi: Тип; | C.2.1 | Mbiemri ose emri i biznesit; Презиме или пословно име; Surname or business name; Hajzer Hajdari B.I. | S.1 | Numri i uleseve; Број места за седење; Number of seats; | | | |
| | C .2. 2 | Einn: | | Numri i vendeve për qëndrim; Број места за стајање; Number of standing places; | | 2A | Ndërtimi; Конструкција; Construction; Kamionetë dubelkab |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Anpera: | " Míreme Ón Podujeve | | Q | Ràporti Fuqi/Peshë [në kW/kg]; Oa«ocCnardaenmne (yrBür) | | Shënime; Напомене; Remarks; |
| B | Data e regjistrimit te parë; Датум прве регистрације Date of first registration; | 24.02.2006 | * | F | #elhl Маса; | 2800 | N.N.T. " Genti " |
| | | | | FI | Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar; Највећа дозвољена маса; Maximum permissible laden mass; | 800 | |
| | | / ERCEDES-BENZ | | G | | 2000 | |
| | | 02.6 | | K | Homologimi; Хомологирање; | | |

KONTRATE(MARREVESHJE) PËR HUAZIM (SHFRYTËZIM) TE MAKINERISË

Lidhur në mes: **BEREQETI - ING SH.P.K.** seli në **Gllogoc, Korroticë e Epërme, Parku i Biznesit, P.n.,** me **NUI: 810845638**
**(Huamarrësi)**

Dhe

**N.N.SH. "CO – ING"** me seli në Prishtinë, Kroi i bardhe . nr **78,** me **NUI:811297466**
**(Huadhënësi)**

Me këtë marrëveshje obligohet huadhënësi për dhënje me qira të mjeteve huamarrësit për realizimin (deri në përfundim të projektit) e projektit me titull : **Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, ulëseve për parqe dhe kontenjerëve**

**Nr. i Prokurimit: 632-23-2711-1-2-1**

**Marrëveshja është arritur në mes të Huadhënësit dhe Huamarrësit për mjetet (makineritë) në bazë të listës së makinerive.**

**Vërejtje: Librezat dhe dokumentet tjera përcjellëse gjeni të bashkëngjitura.**

**Kjo marrëveshje u lidh në Prishtinë, me datë 27.04.2023**

**BEREQETI – ING SH.P.K** | **N.N.SH. "CO – ING"**

CO-ING
Consulting-Engineering

2022

LISTA E PAISJEVE

| Nr. | Lloji I makinës | Marka dhe tipi | Lloji I motorrit | Viti i prodhimit | Nr. I shashisë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | EXCAVATOR | SCHAEFF:HML30E | Diesel | 1989 | 323386 |
| 2 | VIBER PLLAKË | WACKER | Diesel | 1999 | 178 F |
| 3 | NGJESHES DHEU | WACKER BS 600 | Benzinë | 1998 | 755105185 |
| 4 | EXCAVATOR | SENNBOGEN | Diesel | 1987 | 5130483 |
| 5 | EXCAVATOR | LIEBHERR | Diesel | 1992 | 356307 |
| 6 | EXCAVATOR | OK MH CITY | Diesel | 1996 | 78501 |
| 7 | EXCAVATOR | LIEBHERR TIPI 904 Lictronic | Diesel | 2001 | 6657442 |
| 8 | EXCAVATOR | KUBOTA,KX161-3 | Diesel | 2007 | WKFRGX040Z077258 |
| 9 | EXCAVATOR | YANMAR VIO 70 | Diesel | 2000 | 05482B - R 7897 |
| 10 | MAKINE NGARKUESE ME LOPATE E RE | WHEEL LOADER OJ-16 | | 2020 | 918C1175 |
| 11 | MAKINË NGJESHËSE | AMMANN AV12 | Diesel | 1997 | TFV12NYW000645 |
| 12 | KAMION KIPER ME 2 DYER | MERCEDES BENZ 972.02 | Diesel | 2001 | WDB9720211K535273 |
| 13 | PRERESE E ASFALTIT | CEDIMA CF 155 | | 2000 | 0-01545276 |
| 14 | RRAFSHUES BETONI | 2HP SNK POWER | Benzinë | | |
| 15 | NGJESHES DHEU | 6.5HO SNK | Benzinë | | |
| 16 | GJENERATOR,1 cope | MB12000LN-E | | | |
| 17 | APARAT PER MATJE GJEODEZIKE | NEDO | / | 1998 | N02318 |
| 18 | MAKINË PËR PASAGJER | VW PASSAT 3C | Diesel | 2007 | WVWZZZ3CZ7P148176 |
| 19 | GOLDON ME FREZ | | | | |
| 20 | PAHI PER KALLOPIM | | | 2014 | |
| 21 | MAKINE PER SALLDIM DHE APARATET TJERA PERCJELLESE | WELTECH - W315 BUTT WELDING MACHINE D.90-315=1 pce | | 2020 | 1170-03 |
| 22 | MAKINE PER NGJESHJEN E RRUGEV-RUL (VALAK) I PERDORUR | ABG- PUMA 168 | Diesel | 1979 | 168133 |
| | | | | | |

N.N.SH "CO-ING" PRISHTINË

Pretendimi se nuk është precizuar se cilat makineri jan huazuar nga OE"Genti", nuk qëndron sepse marrëveshjes i është bashkangjitur libreza e qarkullimit e automjetit të huazuar e cila qartëson se për cilin automjet është fjala;

Ndërsa sa i përket asaj se lista e makinave të huazuara e dorëzuar nga OE Coing", është e vitit 2022, Autoriteti kontraktues sqaron se kjo nuk përbën problem sepse kryesore marrëveshja mes OE Bereqeti Ing dhe OE Coing është lidhur për këtë projekt, kurse listën OE Coing mund ta ketë pasur më herët të gatshme dhe janë pajtuar që për ato mjete të lidhim marrëveshje huazimi.

Pretendimi juaj lidhur me atë se kamionetat janë të pa regjistruara nuk qëndron , sepse OE Bereqeti ka prezantuara dy kamjoneta ku njëra është e huazuar dhe tjetra ka marrëveshjen e shitblerjes, dhe që të dyja kanë afat valid të regjistrimit

Vlen deri: Valid to: 23.09.2021

Vula: Stamp:

16.12.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

RKS

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

01-254-OM

CRA/YPB/VRC 1541384 CRA/YPB/VRC 1541384 CRA/YPB/VRC 1541384

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | | D3 | 211 CDI | P | | | |
| I | 23.09.2020 | E | [illegible]S9026221R811563 | P1 | 214d | | |
| C | [illegible] | S | 2006 | P2 | | | |
| C | [illegible] | S | 7 | P3 | Dizel - EURO 4 | | |
| C.2.1 | Hajzer Hajdari B.I. | S.1 | | R | 2 - E PORTOKALLTË | | |
| C.2.2 | [illegible] | S.2 | | 2A | Kamjonetë dubolkabinë me 3 dyer | | |
| C.2.3 | Mirëme Ön Podujeve | Q | | | | | |
| B | 24.02.2006 | F | 2800 | | N.N.T. " Genti " | | |
| D | | F1 | 800 | | | | |
| D.1 | / ERCEDES-BENZ | G | 2000 | | | | |
| D.2 | 02.6 | K | | | | | |

LRP. nr. 4434/2023
Ref. nr. 1249/2023

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**NOTER**
**HALIL O. RRUKIQI**
**GLLOGOC**

## KONTRATË MBI SHITBLERJEN E AUTOMJETIT

Sot, më njëzet e shtatë prill dymijë e njëzet e tre (27.04.2023), para meje Halil O. Rrukiqi, noter në Gllogoc, rruga "Fehmi e Xhevë Lladrovci" nr. 11, janë paraqitur palët: ---

**I. – AL-ENERGY SH.P.K.**, me numër unik identifikues 810035130, me adresë në Gllogoc, rruga: "Ajet Rrukiqi", e përfaqësuar nga pronari **Arlind Mulaj**, i lindur me njëzet e një mars njëmijë nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë (21.03.1997), në Tërdec, me vendbanim në Tërdec, Komuna e Gllogocit, me zotësi të plotë të veprimit, me numër personal 1240341839, i identifikuar me letërnjoftim me numër ID0319282, i lëshuar nga MPB e Kosovës, në cilësinë e shitësit - në tekstin e mëtejmë **SHITËSI**, dhe---

**II. – BEREQETI - ING SH.P.K.**, me numër unik identifikues 810845638, me adresë Korroticë e Epërme, Parku i Biznesit, i përfaqësuar nga pronari **Arben Mazreku**, i lindur me tridhjetë maj njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë (30.05.1978), në Prizren, me vendbanim në Malishevë, me zotësi të plotë të veprimit, me numër personal 1014658145, i identifikuar me letërnjoftimin me numër ID1364707, i lëshuar nga MPB e Kosovës, në cilësinë e blerësit – në tekstin e mëtejmë **BLERËSI**.---

**EKSPOZE:** ---
Shitësi është pronar i automjetit lëndë i kësaj kontrate, të cilin me vullnetin e tij të lirë dhe pa kurrfarë shtrëngimi apo presioni nga askush dëshiron t'ia shes blerësit, derisa blerësi dëshiron që këtë automjet ta blejë nga shitësi. Me qëllim të rregullimit të raporteve kontraktuale mes tyre, palët kanë kërkuar nga noteri përpilimin dhe vërtetimin e kësaj kontrate të shitblerjes së automjetit. ---

**I. LËNDA E KONTRATËS:** ---
Lëndë e kësaj kontrate të shitblerjes është automjeti me të dhënat: Prodhuesi **VOLKSWAGEN-VW**, tipi **70X02D**, e vitit të prodhimit 1998, me ngjyrë e bardhë, kamionete dubelkabine me 3 dyer, lloji i karburantit dizel, me numër identifikues **WV1ZZZ70ZWH140246**, me numër të targave **01-968-SF**. Të dhënat janë dëshmuar me certifikatën e regjistrimit të automjetit, me numër CRA 1850459, ku sipas kësaj certifikate regjistrimi i këtij automjeti skadon me datë 23.061.2023. ---

**II. ÇMIMI I SHITBLERJES:** ---
Palët kontraktuese janë pajtuar që çmimi i shitjes së automjetit, objekt i kësaj kontrate, të jetë **1,000.oo €** (njëmijë euro). Palët janë pajtuar që pagesa e çmimit të shitblerjes të bëhet më së largu me datë 30.06.2023 (tridhjetë qershor dymijë e njëzet e tre), përmes transferit bankar. ---

**III. BARRA (PENGU):** ---
Shitësi deklaron me përgjegjësin penale materiale dhe morale se automjeti nuk është pengë, për të siguruar ndonjë kredi në bankat e Kosovës, e gjithashtu nuk ka ndonjë kontest apo pretendim me palë të treta në lidhje me këtë automjet. Noteri e ka bërë verifikimin në sistemin online në zyrën e pengut, dhe nga ky verifikim rezulton se automjeti nuk është i regjistruar peng. ---

**IV. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT MATERIALE:** ---
Palët deklarojnë se blerësi automjetin e ka blerë në bazë të shikimit dhe e ka testuar anën funksionale të automjetit, prandaj shitësi nuk përgjigjet për të metat materiale të automjetit. ---

**V. PËRGJEGJËSIA PËR TË METAT JURIDIKE:** ---

Shitësi i merr të gjitha përgjegjësit sa i përket dokumentacionit dhe të metave të mundshme juridike që ka të bëjë me këtë automjet. Shitësi gjithashtu merr përsipër të zgjidh në të ardhmen çdo kontest eventual në lidhje me këtë automjet nëse kontesti i referohet periudhës sa shitësi ka pasur automjetin në posedim apo nëse ka ditur për një gjë të tillë por i ka fshehur blerësit. ---

**VI. KALIMI I POSEDIMIT DHE I PRONËSISË, NGARKESAVE DHE RREZIQEVE** ---

Shitësi është i pajtimit që automjetin me dokumentet e nevojshme t'ia dorëzoj blerësit në posedim dhe t'ia bartë të drejtën e disponimit, respektivisht të pronësisë me datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.---

Posedimi, ngarkesat dhe rreziqet, kalojnë tek blerësi në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate para noterit, dhe ai është përgjegjës i vetëm për të gjitha pasojat në kuptim të rregullave rrugore dhe të tjera. ---

Shitësi me rastin e dorëzimit të dokumentacionit të automjetit, blerësit i ka dorëzuar edhe Policën e Sigurimit të Automjetit, lëshuar nga Kompania e Sigurimeve dhe e autorizon blerësin që ta përfaqësojë të njëjtin në Kompaninë e Sigurimit në procedurën e anulimit të Policës së Sigurimit dhe të gjitha parat e kthimit të bartën në llogari të blerësit.---

**VII. DEKLARATAT PËR REGJISTRIM TË MJETIT MOTORIK** ---

1. Shitësi e autorizon blerësin që ta përfaqësoj të njëjtin në të gjitha QRA-të në procedurën e ç'regjistrimit të automjetit dhe dorëzimin e tabelave të regjistrimit të automjetit e më pas të njëjtin automjet ta regjistroj menjëherë në emër të tij, pa prezencën e mëtejmë të shitësit dhe më së voni në afatin prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, ku edhe duhet bërë kërkesa për Regjistrim të këtij mjeti motorik në QRA-në kompetente. ---
2. Palët kontraktuese janë këshilluar se nëse ndonjëri prej tyre ka gjobë për kundërvajtje në komunikacion, nuk mund të regjistrohet pronari i ri derisa nuk e paguhet gjoba për kundërvajtje në trafik.---

**VIII. UDHËZIMET DHE PARALAJMËRIMET** ---

Noteri i udhëzoi dhe paralajmëroi palët edhe si vijon:---

— se e drejta e pronësisë fitohet me dorëzimin e sendit dhe me këtë kontratë dhe regjistrimin e automjetit nga vetë blerësi, i cili kopjen e vërtetuar të kësaj kontrate do ta dorëzojë për regjistrim para organit kompetent për regjistrimin e mjeteve motorike.---

— se për shpenzimet lidhur me këtë shënim noterial, përgjigjen në mënyrë solidare dhe se mund të kontraktojnë ndryshe, dhe pas kësaj, palët deklarojnë se shpenzimet e këtij shënimi noterial, dhe ---
- shpenzimet e tjera, i bartë blerësi. ---

Noteri udhëzoi dhe paralajmëroi palët mbi obligimet ligjore në kuptim të nenit 56. dhe 63. të Ligjit për Automjete Nr.05/L-132, lidhur me obligimin për njoftimin e organit për çdo ndryshim të të dhënave në lidhje me regjistrimin e automjeteve, ndryshimet teknike, ndryshimi i pronarit, vendbanimit, duhet që brenda tridhjetë (30) ditëve të njoftohet autoriteti kompetent për regjistrimin e automjeteve si dhe obligimin e bartjes së pronësisë, pronari i ri të regjistron mjetin në emër të tij në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga data e blerjes së mjetit. ---

**KONSTATIMET E NOTERIT:** ---

Përmbarueshmëria e dokumentit noterial sipas Ligjit për Noterin Nr. 06/L-010, neni 43. Ky akt është titull ekzekutiv në procedurë përmbarimore dhe palët japin pëlqimin për përmbarim (ekzekutim) të detyrueshëm në rast të mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga kjo kontratë. Noteri i ka njoftuar palët lidhur me efektet dhe pasojat juridike të përmbarimit të detyrueshëm. Pas njoftimeve të noterit blerësi qartë deklaron se pranon ekzekutimin (përmbarimin) e detyrueshëm pa shtyrje në pasurinë e tij të gjithëmbarshme, për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që dalin nga kjo kontratë. ---

Dokumentet që i bashkëngjiten si aneks kësaj kontrate:
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të automjetit,
- Kopja e dokumenteve te biznesit te shitësit,
- Kopja e dokumenteve te biznesit te blerësit,
- Kopja e dokumenti të identifikimit të shitësit dhe blerësit,
- Dëshmia nga sistemi online i zyrës së pengut,

**Përmbyllja**

Noteri u tërheq vërejtjen palëve për përgjegjësinë dhe pasojat të cilave u nënshtrohen në rast të fshehjes së qëllimit të vërtet të tyre në këtë transaksion apo në rast të fshehjes së çmimit real të shitblerjes, ndërsa palët deklarojnë se kanë paraqitur qëllimin e vërtet të tyre në këtë transaksion dhe kanë deklaruar çmimin real të shitblerjes, prandaj i marrin të gjitha përgjegjësitë që kanë të bëjnë me këtë transaksion.

Noteri u lexon aktin palëve të paraqitura para tij dhe gjithashtu u jep aktin për lexim palëve, të cilët deklarojnë se e kanë kuptuar përmbajtjen e aktit, akti paraqet shprehjen besnike dhe të vërtet të vullnetit të tyre dhe se janë të pajtimit me aktin e përpiluar nga noteri.

Në rast të gabimeve teknike apo gjuhësore në këtë akt, palët e autorizojnë noterin që vetë të bëjë përmirësimin në akt.

Palët e paraqitura dëshmuan identitetin e tyre, ato kanë zotësi veprimi.

Kompenzimi për punën dhe shpenzimet e noterit, në bazë të Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 05/2022 për Tarifat Noteriale, neni 23.1, neni 42.1 dhe neni 42.2 + 18%TVSH, janë 21.24 €.

Kontrata, sipas Ligjit të Noterisë së Kosovës, është përpiluar në një origjinal që mbetet tek noteri, ndërsa palët sipas ligjit marrin nga një ekstrakt të vërtetuar nga origjinali, që është njësoj e vlefshme, ndërsa një kopje i dorëzohet nga blerësi Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në kohën e regjistrimit të automjetit në emër të tij.

Veprimi i noterizuar u zhvillua pa ndërprerje, në prani të gjithë personave në zyrën e noterit, në Gllogoc, me njëzet e shtatë prill dymijë e njëzet e tre (27.04.2023), ora 08:50h.

Kjo kontratë është e përpiluar në tri (3) faqe të shkruara në tri (3) fletë.

PALËT KONTRAKTUESE

| SHITËSI: | BLERËSI: |
|---|---|
| AL-ENERGY SH.P.K | BEREQETI - ING SH.P.K. |
| Arlind Mulaj | Arben Mazreku |

NOTERI
Halil Q. Rrahmani


01 968-SF







Kurse sa i përket asaj se njëra kamionetë peshon 2.57 t, sqarojmë se në FDT fjala ka qenë për atë se sa duhet të ketë peshën bartëse makineria e jo sa peshon ajo;

Pretendimi juaj lidhur me sigurimin e tenderit nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues ka bërë njoftimin për kontratë 24.03.2023.
Afati për sqarime shtesë ka qenë deri me dt.07.4.2023.
~~Me dt 06.04.2023,një OE ka kërkuar sqarime shtesë.~~
Lidhur me këto sqarime shtesë kemi kthyer përgjigje me dt.14.04.2023 dhe kemi shtyer afatin e hapjes së ofertave deri me dt.27.04.2023.
OE Bereqeti ka bërë sigurimin e tenderit me vlefshmëri nga dt.18.04.2023 deri 19.07.2023(të cilin ja bashkangjesim këtij vendimi);

Pretendimi juaj lidhur kontratat e natyrës së ngjashme nuk qëndron, sepse OE Bereqeti, vetëm me referencën e lëshuar nga Kema Company sh.p.k., e mbulon shumën e kërkuar në FDT:

KEMA COMPANY

- Kema Company Sh.p.k
- Nr Biznesi : 810382309
- Tel: 044 205 775
- Adresa: Lipjan, , Te QMI-a

Data: 03.02.2022

Me kërkesen e kompanisë BEREQETI ING SH.P.K me nr biznesi 810845638 me adrese : Parku i biznesit-Drenas leshojmë këtë:

**REFERENC PUNE**

Me kompaninë BEREQETI ING SH.P.K nga Drenasi kemi punuar gjatë vitit 2021 jemi funizuar me ulëse për park me shporta të vogla dhe me produkte te tjera , ku vlera e bashkëpunimit gjatë këtij viti ka qenë 111,520.00 €

Andaj ne si kompani e konsiderojmë që kompani BEREQETI ING SH.P.K është ndër kompanitë me profesionale në laminë që operon në Kosovë.

Bashkëpunimi me këtë kompani ishte i suksesshëm,prandaj shpresojmë që një bashkëpunim i tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Këtë reference kompania BEREQETI ING SH.P.K mund ta shfrytëzojë si referenc pozitve për kompanitë të cilat mendojë tëbashkëpunojnë me të në të ardhmen.

Drejtori

KEMA COMPANY

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

PRISIG
KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

**POLICË SIGURIMI**
*INSURANCE POLICY*

# Sigurimi për Garanci
# Guarantee Insurance

Për

**Seria** 10000537643

KOMUNA E GJAKOVËS

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

| | |
|---|---|
| Titulli / Title | Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, ulëseve për parqe dhe kontenjerëve |
| Emri i Ofertuesit / Name of the Bidder | BEREQETI - ING SH.P.K. |
| Adresa / Address | Korroticë e Epërme, Parku i Biznesit, P.n. |
| Telefon / Telephone | +38344386007 |
| Numri i personal / biznesit / Personal / business number | 810845638 |
| Data e lëshimit / Date of issue | 14.04.2023 |
| Numri i prokurimit / Procurement number | 632-23-2711-1-2-1 |
| Lloji i kontratës / Contract type | Garanci Oferte |
| Prej / From | 18.04.2023 |
| Deri / To | 19.07.2023 |
| Shuma e sigurimit / Insured sum | 2,000.00 € |
| Primi / Premium | 30.00 € |
| TVSH / VAT | 5.40 € |
| Totali për pagesë / Total for payment | 35.40 € |

AUTORITETI KONTRAKTUES

| | |
|---|---|
| Numri personal / biznesit / Personal / business number | 00000000 |
| Adresa / Address | Rr "Nënë Tereza" |
| Vendi / City | GJAKOVË |
| Telefon / Telephone | 038-200-44041 |

## Policë e sigurimit

*DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëqofëse ka fshehje apo shtrembërim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblimi në rast dëmi.*

*Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje më Ligjin nr.03/L-196 si dhe paragrafin 6 të Rregullorës Nr.X të Bankës Qëndrore të Kosovës.*

## Insurance Policy

*I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage.*

*The policyholder declares that the origin of funds is in accordance with Law no.03 / L-196 as well as paragraph 6 of Regulation No. X of the Central Bank of Kosovo.*

Agjenti

Prisig Online

KOMPANIA E SIGURIMEVE - PRISIG - SHOQËRI AKSIONARE
PRISIG

**PRISIG**
KOMPANIA E SIGURIMEVE - INSURANCE COMPANY

# POLICË SIGURIMI
*INSURANCE POLICY*

## Lloji i Garancisë: Garanci Oferte

Për

Seria 10000537643

KOMUNA E GJAKOVËS

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

BEREQETI - ING SH.P.K.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Furnizimi dhe vendosja e kapakëve të pusetave dhe grilave të ujëmbledhësve, uleseve për parqe dhe kontenjerëve

të dhënë me numrin e Prokurimt

632-23-2711-1-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoritieti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

2,000.00 € | Dy Mije e Euro

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;

c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:

- Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
- Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej:

2,000.00 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës 18.04.2023 deri më 19.07.2023

Lëshuar në Prishtinë datë 14.04.2023

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

KOMPANIA E SIGURIMEVE - PRISIG - SHOQËRI AKSIONARE
PRISIG
PRISHTINË

Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000
Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës